

**LIGJI NR. 08/L-155****PËR SANKSIONET E SHËNJESTRUARA  
KUNDËR SHKELËSVE TË HUAJ TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR SANKSIONET E SHËNJESTRUARA  
KUNDËR SHKELËSVE TË HUAJ TË TË DREJTAVE TË NJERIUT****KAPITULLI I  
DISPOZITAT THEMELORE****Neni 1  
Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton kriteret dhe procedurën për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara kundër shkelësve të huaj të të drejtave të njeriut dhe kryerësve të huaj të veprave të rënda të korrupsionit me qëllim të mbështetjes së demokracisë, sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

2. Ky ligj është në përputhshmëri të pjesshme me:

2.1. Vendimin e Këshillit, (Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë-PPJS) 2020/1999 të 7 dhjetorit 2020, për masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut;

2.2. Rregulloren e Këshillit (BE) 2020/1998 të 7 dhjetorit 2020, për masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet ndaj të huajve të cilët janë përgjegjës ose ndihmojnë në kryerjen e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe veprave të rënda të korrupsionit.

2. Ky ligj zbatohet edhe ndaj personave që asocohen me personat nga paragrafi 1 i këtij neni.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij ligji, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1. I huaj - :**

1.1.1. çdo person fizik i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, përkatësisht çdo person juridik që nuk është i themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës apo i regjistruar në Republikën e Kosovës, përfshirë akterët shtetërorë, akterë që ushtrojnë kontroll efektiv apo pushtet mbi një territor, si dhe akterët tjerë

jo-shtetërorë;

1.1.2. personi fizik me më shumë shtetësi konsiderohet i huaj përveç nëse ka edhe shtetësinë e Republikës së Kosovës.

1.2. **Person i shënjestruar** - shkelësit e huaj të të drejtave të njeriut, kryerësit e huaj të veprave të rënda të korrupsionit, përfshirë ndihmësit, si dhe personat e asocuar me ta, ndaj të cilëve janë vendosur sanksione të shënjestruara në përputhje me këtë ligj.

1.3. **Ndihmës** –personi i cili ndihmon financiarisht, ofron mbështetje teknologjike ose materiale, apo është i përfshirë në ndonjë mënyrë tjetër në veprat e cekura në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, përfshirë planifikimin, drejtimin, urdhërimin, asistimin, përgatitjen, lehtësimin ose inkurajimin në kryerjen e veprave të tilla;

1.4. **Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut** – përfshijnë shkeljet dhe abuzimet si:

1.4.1. gjenocidi;

1.4.2. krimet kundër njerëzimit;

1.4.3. tortura dhe çfarëdo trajtimi dhe dënimi mizor, çnjerëzor dhe degradues;

1.4.4. skllavëria;

1.4.5. ekzekutimet dhe vrasjet jashtëgjyqësore, të menjëhershme dhe arbitrare;

1.4.6. zhdukja e detyruar të personave;

1.4.7. arrestimet dhe ndalimet arbitrare;

1.4.8 shkeljet ose abuzimet tjera të të drejtave të njeriut, duke përfshirë por pa u kufizuar në shkeljet në vijim, për aq sa ato shkelje ose abuzime janë të përhapura, sistematike apo shqetësim serioz në ndonjë formë tjetër:

1.4.8.1. shkeljen apo abuzimin e zgjedhjeve demokratike dhe të drejtës së votës;

1.4.8.2. trafikimi me njerëz dhe çfarëdo abuzimi i të drejtave të njeriut nga kontrabanduesit me emigrantë;

1.4.8.3. dhuna seksuale dhe dhuna në baza gjinore;

1.4.8.4. shkeljet dhe abuzimet e lirisë së tubimit paqësor dhe asociimit;

1.4.8.5. shkeljet dhe abuzimet e lirisë së shprehjes dhe mendimit;

1.4.8.6. shkeljet dhe abuzimet e lirisë së fesë dhe të besimit.

1.5. **Veprat e rënda të korrupsionit** - përfshijnë keqpërdorimin e pasurive të shtetit, shpronësimin e pasurive publike apo private për përfitime personale, korrupsionin në lidhje me kontratat qeveritare ose nxjerrjen e burimeve natyrore, ryshfetin, transferimin ose lehtësimin e transferimit të të ardhurave nga korrupsioni të cilat rezultojnë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i këtij neni.

1.6. **Resurset ekonomike** - përfshijnë të gjitha asetet e prekshme apo të paprekshme, të luajtshme apo të paluajtshme, të cilat nuk janë fonde, por mund të përdoren për

sigurimin e fondeve, mallrave dhe shërbimeve.

**1.7. Sekuestrimi i resurseve ekonomike** - përfshin ndalimin e përdorimit të resurseve ekonomike me qëllim të përfitimit të fondeve, mallrave ose shërbimeve në çfarëdo mënyre, përfshirë por pa u kufizuar në shitjen, kontraktimin ose kolateralizimin e tyre.

**1.8. Fonde** - të gjitha asetet financiare dhe të gjitha përfitimet, duke përfshirë por mos u kufizuar në:

1.8.1. para të gatshme, çeqe, kërkesat në para, draftet, urdhrat në para, dhe instrumente të tjera të pagesës;

1.8.2. depozitat me institucione financiare ose entitete të tjera, bilancet në llogari, borxhet dhe obligimet lidhur me borxhe;

1.8.3. letrat me vlerë dhe instrumentet e borxhit të tregtuara publikisht ose privatisht, përfshirë stoqet dhe aksionet, certifikatat e letrave me vlerë, obligacionet, notat, urdhërpagesat, borxhet dhe kontratat derivative;

1.8.4. interesin, dividendat ose të ardhurat, ose vlerat tjera që rrjedhin ose gjenerohen nga pasuria;

1.8.5. kreditë, të drejtën e cedimit, garancitë, obligacionet performuese ose detyrime tjera financiare;

1.8.6. letra krediti, faturat e ngarkesës, faturat e shitjes;

1.8.7. dokumente që dëshmojnë interes në fonde ose burime financiare.

**1.9. Sekuestrimi i fondeve** - ndalimin e çfarëdo zhvendosjeje, transferimi, ndryshimi, përdorimi, qasjeje ose disponimi me fonde në çfarëdo mënyre që do të kishte për pasojë ndryshimin e vëllimit, vlerës, vendndodhjes, pronësisë, posedimit, karakterit, destinimit ose çfarëdo ndryshimi tjetër që do të mundësonte që këto fonde të përdreshin, përfshirë menaxhimin e portfolios.

**1.10. Subjekte përgjegjëse** - institucionet e Republikës së Kosovës dhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë në Republikën e Kosovës të cilët janë përgjegjës për zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimeve të Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara.

**1.11. Institucionet financiare** –të gjitha bankat, institucionet financiare jobankare dhe institucionet mikrofinanciare, siç parashihen në ligjin përkatës për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

2. Për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut zbatohet e drejta ndërkombëtare zakonore dhe Instrumentet e të drejtës ndërkombëtare si vijon:

2.1. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike;

2.2. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;

2.3. Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit;

2.4. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;

- 2.5. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- 2.6. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- 2.7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- 2.8. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar;
- 2.9. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- 2.10. Protokollin mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve;
- 2.11. Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale;
- 2.12. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

## **KAPITULLI II SANKSIONET E SHËNJESTRUARA**

### **Neni 4 Llojet e sanksioneve të shënjestruara**

1. Personave të shënjestruar sipas këtij ligji iu vendosen këto sanksione:
  - 1.1. ndalimi i hyrjes ose kalimit transit në territorin e Republikës së Kosovës;
  - 1.2. sekuestrimi i fondeve dhe resurseve ekonomike; dhe
  - 1.3. mosvënia në dispozicion e fondeve dhe resurseve ekonomike.
2. Sanksionet nga paragrafi 1 i këtij neni zgjasin derisa personi i shënjestruar hiqet nga lista e personave të shënjestruar me vendim të Qeverisë apo të gjykatës, siç parashihet me këtë ligj.

### **Neni 5 Ndalimi i hyrjes ose kalimit transit në territorin e Republikës së Kosovës**

Institucionet e Republikës së Kosovës ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në përputhje me legjisllacionin në fuqi për të ndaluar hyrjen ose kalimin transit të personave të shënjestruar nëpër territorin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 6 Përjashtimet nga ndalimi i hyrjes ose kalimit tranzit në territorin e Republikës së Kosovës**

1. Përjashtimisht nga neni 5 i këtij ligji, sipas kërkesës, Ministri përkatës për punë të jashtme, me vendim, autorizon hyrjen ose kalimin transit në territorin e Republikës së Kosovës të personave të shënjestruara në rastet kur Republika e Kosovës ka obligime sipas të drejtës ndërkombëtare:
  - 1.1. si shtet nikoqir i një organizate ndërkombëtare ndërqeveritare;
  - 1.2. si shtet nikoqir i një konference ndërkombëtare të organizuar nga ose nën patronatin e Kombeve të Bashkuara;

1.3. si shtet nikoqir i Organizatës Europiane për Siguri dhe Bashkëpunim;

1.4. sipas një marrëveshjeje shumëpalëshe që njeh privilegje dhe imunitete.

2. Përveç rasteve nga paragrafi 1 i këtij neni, Ministri përkatës për punë të jashtme, sipas kërkesës, me vendim, mund të autorizojë hyrjen ose kalimin transit në territorin e Republikës së Kosovës të personave të shënjestruara në rastet kur:

2.1. hyrja ose kalimi transit është i domosdoshëm me qëllim të zhvillimit të një procesi gjyqësor;

2.2. udhëtimi arsyetohet mbi bazën e një nevoje urgjente humanitare;

2.3. personi i shënjestruar merr pjesë në takime ndërqeveritare ose takime të organizuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe që drejtpërdrejtë promovojnë qëllimet e politikave të sanksioneve të shënjestruara, përfshirë përfundimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve, si dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

3. Kërkesa nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni duhet të paraqitet të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së udhëtimit, përveç në rastet e natyrës urgjente;

4. Ministri përkatës për punë të jashtme autorizon hyrjen ose kalimin transit në territorin e Republikës së Kosovës të personave të shënjestruara sa më shpejtë që është e mundur e më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë nga pranimi i kërkesës, përveç kur për shkaqe të arsyeshme lëshimi i autorizimit sipas këtij afati është i pamundur.

5. Autorizimi për hyrje dhe kalim transit sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në mënyrë strikte i kufizuar për qëllimin dhe periudhën për të cilin është dhënë dhe t'i drejtohet personit të shënjestruar drejtpërdrejtë.

6. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni i dërgohet Ministrisë përkatëse të punëve të brendshme dhe institucioneve të tjera kompetente për zbatimin e këtij ligji.

## **Neni 7**

### **Sekuestrim i fondeve dhe resurseve ekonomike**

Personave të shënjestruar sipas këtij ligji iu sekuestrohen të gjitha fondet dhe resurset ekonomike që i kanë në posedim, pronësi dhe që mbahen ose kontrollohen nga ta, përveç në rastet e parapara sipas këtij ligji.

## **Neni 8**

### **Ndalimi i vënies së fondeve dhe resurseve ekonomike në dispozicion të personave të shënjestruar**

1. Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të gjithë personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Kosovës, ju ndalohet vënia e fondeve dhe resurseve ekonomike në dispozicion të personave të shënjestruar sipas këtij ligji, përveç në rastet e parapara sipas këtij ligji.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk ndalon kreditimin e llogarive të sekuestruara nga një institucion financiar që pranon dërgime të fondeve të transferuara nga një palë e tretë në llogarinë e personit të shënjestruar, me kusht që vlera e transferuar në ato llogari po ashtu sekuestrohet.

3. Paragrafi 1 i këtij ligji nuk zbatohet ndaj rritjes së vlerës në llogaritë e sekuestruara sipas:

3.1. interesit ose fitimeve të tjera në ato llogari;

3.2. pagesave që duhet të bëhen sipas kontratave, marrëveshjeve ose obligimeve që janë lidhur ose që kanë lindur përpara datës në të cilën personi është shënjestruar; ose

3.3. pagesave që duhet të bëhen sipas vendimeve gjyqësore, administrative ose të arbitrazhit të marra në Republikën e Kosovës ose të ekzekutueshme në Republikën e Kosovës.

4. Interesi, pagesat ose fitimet tjera nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni sekuestrohen pa vonesë.

5. Institucioni financiar njofton Ministrinë përkatëse të Punëve të Jashtme në rastet nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni.

6. Zyrat kadastrale komunale, noterët dhe të gjitha institucionet tjera kompetente që mbajnë ose administrojnë regjistra të fondeve dhe pasurive duhet të konsultojnë listën e personave të shënjestruar para regjistrimit, hartimit ose vërtetimit të një kontrate ose transaksioni për pasurinë.

### **Neni 9**

#### **Përrjashtimet nga sekuestrimi dhe vënia e fondeve dhe resurseve ekonomike në dispozicion**

1. Përrjashtimisht nga neni 7 dhe 8 i këtij ligji, sipas kërkesës, Ministri përkatës për punë të jashtme, me vendim mund të autorizojë:

1.1. zhbllokimin e një pjese të fondeve ose resurseve ekonomike të sekuestruara ose lejimin e vënies së resurseve ekonomike në dispozicion, sipas kushteve të caktuara, nëse ato fonde dhe resurse ekonomike janë:

1.1.1 të domosdoshme për të mbuluar nevojat themelore të personit të shënjestruar dhe anëtarëve të familjes ndaj të cilëve ka detyrim të mbajtjes, përrfshirë pagesat për ushqimi, qira ose kredi, ilaçe dhe trajtim mjekësor, taksa, prim të sigurimit dhe shërbime komunale;

1.1.2. të domosdoshme për pagesën e shpenzimeve të arsyeshme profesionale ose për rimbursimin e shpenzimeve të bëra për shërbime ligjore;

1.1.3. të domosdoshme për pagesën e tarifave ose çmimit të shërbimeve lidhur me mirëmbajtjen e fondeve ose resurseve ekonomike të sekuestruara, kur përcaktohet me legjislacionin në fuqi, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;

1.1.4. të domosdoshme për shpenzime të jashtëzakonshme, kur autoriteti relevant i shtetit tjetër ka njoftuar Ministrinë përkatëse për Punë të Jashtme për shkaqet sipas të cilave konsideron se një autorizim specifik duhet të jepet, të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara kohës kur kërkohet dhënia e autorizimit;

1.1.5. për të realizuar pagesa në apo nga llogaria e një misioni diplomatik ose konsullor ose e një organizate ndërkombëtare që gëzon imunitet në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, kur ato pagesa përdoren për qëllime zyrtare të misionit diplomatik ose konsullor ose të organizatës ndërkombëtare; ose

1.1.6. për arsye humanitare, siç është ofrimi ose lehtësimi i ofrimit të ndihmës, përrfshirë furnizimet mjekësore, ushqimit, ose transferimi i punonjësve humanitarë dhe ndihmës së ndërlidhur, ose për evakuime, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

1.2. zhbllokimin e një pjese të fondeve ose resurseve ekonomike të sekuestruara nëse fondet ose resurset ekonomike përdoren ekskluzivisht për të paguar kërkesat e

siguruara nga ose njihen si të vlefshme sipas një vendimi të arbitrazhit të marrë përpara datës në të cilën i huaji është shënjestruar, ose me një vendim administrativ ose gjyqësor të marrë në Republikën e Kosovës, ose një vendim gjyqësor të ekzekutueshëm në Republikën e Kosovës, përpara ose pas asaj date, nëse:

1.2.1. vendimi nuk shkon në dobi të personave të shënjestruar; dhe

1.2.2. njohja e vendimit nuk është në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Kosovës;

1.3. zhbllokimin e një pjese të fondeve ose resurseve ekonomike të sekuestruara nëse nga një person i shënjestruar pritet të bëhet një pagesë sipas një kontrate ose marrëveshje që është lidhur nga ai ose një obligimi që ka ekzistuar para datës kur personi është shënjestruar, nëse përcakton se:

1.3.1. fondet ose resurset ekonomike do të përdoren për një pagesë nga një person i shënjestruar; dhe

1.3.2. fondet ose resurset ekonomike për kryerjen e pagesës nuk i vihen në dispozicion personit të shënjestruar, siç përcaktohet në nenin 8 të këtij ligj.

2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni i dërgohet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

### **KAPITULLI III PROCEDURA PËR VENDOSJEN E SANKSIONEVE TË SHËNJESTRUARA**

#### **Neni 10**

#### **Propozimi për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara**

1. Ministria përkatëse e punëve të jashtme identifikon personat nga neni 2 i këtij ligji dhe i propozon Qeverisë vendosjen e sanksioneve të shënjestruara ndaj tyre.

2. Propozimi për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara duhet të përmbajë informata të nevojshme për identifikimin e personave nga neni 2 i këtij ligji me të dhënat identifikuese të cilat janë të njohura, si:

2.1. Për personat fizikë: emrat dhe mbiemrat në shqip dhe në shqiptimin origjinal siç parashihen në dokumentet e identifikimit, pseudonimet apo emrat e tjerë, gjininë, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë, adresën e vendqëndrimit të zakonshëm, numrin identifikues ose numrin e pasaportës, si dhe funksionin dhe profesionin.

2.2. Për grupet, personat ose subjektet juridike: emrin, vendin e regjistrimit, datën e regjistrimit, numrin e regjistrimit dhe selinë.

3. Propozimi për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara duhet të përmbajë arsyet për propozimin për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara.

#### **Neni 11**

#### **Burimet e informacionit**

1. Burimet e informacionit për identifikimin e personave nga neni 3, nënparagrafi 1.2 i këtij ligji janë:

1.1. Informacionet e brendshme zyrtare, që përfshijnë informacionet e siguruara nga

institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë, por pa u kufizuar në: Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Njësinë për Inteligjencë Financiare, Ministrinë përkatëse të punëve të brendshme dhe Ministrinë përkatëse të punëve të jashtme;

1.2. Informacionet e jashtme zyrtare, që përfshijnë informacionet e besueshme, të siguruar nga shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë listat publike të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare që listojnë personat nga neni 2 i këtij Ligji;

1.3. Informacionet e tjera, që përfshijnë informacionet e besueshme nga mediat dhe organizatat e shoqërisë civile vendore dhe ndërkombëtare që identifikojnë shkeljet e të drejtave të njeriut.

2. Të dhënat e siguruar në përputhje me këtë ligj përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mund të përdoren vetëm për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, përveç nëse është paraparë ndryshe me legjislacionin në fuqi.

3. Ministria përkatëse për Punë të Jashtme konsulton në baza të rregullta listat nga paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 i këtij neni.

#### **Neni 12**

##### **Vendimi për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendim të arsyetuar dhe publik, vendosë sanksionet e shënjestruara për personat nga neni 2 i këtij ligji, në bazë të propozimit të Ministrisë përkatëse të punëve të jashtme.

2. Vendimi për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara duhet të identifikojë saktësisht personin nga neni 2 i këtij ligji me të dhënat identifikuese të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 2 i këtij ligji si dhe arsytet për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara.

3. Vendimi i Qeverisë zbatohet drejtpërdrejtë dhe publikohet në një vegëz të veçantë dhe lehtësisht të qasshme në ueb-faqen zyrtare të Gazetës Zyrtare dhe në ueb-faqet zyrtare të institucioneve tjera përkatëse.

#### **Neni 13**

##### **Lista e personave të shënjestruar**

1. Ministria përkatëse e punëve të jashtme përpilon listën e personave të shënjestruar e cila përmban, kur janë të njohura, të dhënat nga neni 10, paragrafi 2 i këtij ligji, datën dhe arsyetimin për vendosjen e sanksioneve.

2. Lista e personave të shënjestruar publikohet në ueb faqen e Ministrisë përkatëse të punëve të jashtme dhe përditësohet, pa vonesë, pas vendosjes, përkatësisht heqjes së sanksioneve të shënjestruara.

### **KAPITULLI IV**

#### **RISHIKIMI DHE HEQJA E SANKSIONEVE TË SHËNJESTRUARA**

#### **Neni 14**

##### **Rishikimi i sanksioneve të shënjestruara**

1. Ministria përkatëse e punëve të jashtme shqyrton listën e personave të shënjestruar në rastet:

1.1. sipas detyrës zyrtare, në baza të rregullta së paku një (1) herë në vit;



1.2. kur personi i shënjestruar paraqet vërejtje dhe pikëpamje sipas nenit 16, paragrafit 3 të këtij ligji;

1.3. kur pranon prova thelbësore nga burimet e informacioneve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, përfshirë edhe informacionet rreth dënimit të personit të shënjestruar në vendin e origjinës për veprat për të cilat ai është shënjestruar në Republikën e Kosovës.

2. Vërejtjet dhe pikëpamjet e paraqitura konsiderohen informacione dhe nuk kanë efekt detyrues për Ministrinë përkatëse për Punë të Jashtme.

### **Neni 15**

#### **Heqja e sanksioneve të shënjestruara**

1. Ministria përkatëse e punëve të jashtme i propozon Qeverisë së Republikës së Kosovës heqjen e sanksioneve të shënjestruara kur pas shqyrtimit të listës sipas nenit 14 të këtij ligji vlerëson se kanë ndryshuar rrethanat për shkak se:

1.1. sipas informacioneve të besueshme, personi i shënjestruar nuk ka marrë pjesë në kryerjen e veprimeve për të cilat i është vendosur sanksion;

1.2. personi i shënjestruar ka shfaqur ndryshim rrënjësor në sjellje ose është ndëshkuar për kryerjen e veprimeve për të cilat i është vendosur sanksion; ose

1.3. heqja e sanksioneve është në interes të sigurisë publike të Republikës së Kosovës.

2. Ministria përkatëse e punëve të jashtme duhet t'i propozojë Qeverisë heqjen e sanksioneve të shënjestruara brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga kur të ketë vlerësuar se kanë ndryshuar rrethanat e përcaktuara me këtë nen.

## **KAPITULLI V**

### **NJOFTIMI I VENDIMIT DHE INICIMI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV**

#### **Neni 16**

##### **Njoftimi**

1. Ministria përkatëse e punëve të jashtme njofton pa vonesë personin e shënjestruar me vendimin për vendosjen përkatësisht heqjen e sanksioneve të shënjestruara.

2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni dërgohet drejtpërdrejtë nëse adresa është e njohur, apo përmes publikimit të njoftimit sipas legjislacionit në fuqi.

3. Njoftimi për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara përfshin arsyet për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara dhe mundësinë për të paraqitur vërejtjet dhe pikëpamjet e tij lidhur me vendimin.

#### **Neni 17**

##### **Inicimi i konfliktit administrativ**

1. Vendimi i Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara dhe vendimi i Ministrit përkatës të Punëve të Jashtme për përjashtimet nga sanksionet e shënjestruara të përcaktuara në këtë ligj është përfundimtarë dhe ndaj tij nuk lejohet ankesë.

2. Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, personi i shënjestruar mund të iniciojë konfliktin administrativ në përputhje me ligjin përkatës për konfliktet administrative.

## **KAPITULLI VI ZBATIMI I VENDIMEVE PËR VENDOSJEN DHE HEQJEN E SANKSIONEVE TË SHËNJESTRUARA**

### **Neni 18**

#### **Njoftimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve të Qeverisë**

1. Ministria përkatëse e Punëve të Jashtme njofton institucionet koordinuese me vendimet për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara dhe mbikëqyr zbatimin e vendimeve për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara.
2. Institucionet koordinuese nga paragrafi 1 i këtij neni janë:
  - 2.1. Njësia për Inteligjencë Financiare, për sanksionin e sekuestrimit të fondeve dhe resurseve ekonomike;
  - 2.2. Ministria përkatëse për Punë të Brendshme, për sanksionin e ndalimit të hyrjes dhe kalimit transit në Republikën e Kosovës;
  - 2.3. Ministria përkatëse për Punë të Jashtme, sanksionin e ndalimit të vënies në dispozicion të fondeve dhe resurseve ekonomike.
3. Institucionet koordinuese të përcaktuara në këtë nen, kanë këto përgjegjësi:
  - 3.1. njoftojnë subjektet përgjegjëse përkatëse me vendimet e Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara;
  - 3.2. mbikëqyrin zbatimin e sanksioneve të shënjestruara;
  - 3.3. mbikëqyrin zbatimin e vendimeve të Qeverisë lidhur me heqjen e sanksioneve të shënjestruara;
  - 3.4. i raportojnë Ministrisë përkatëse për Punë të Jashtme lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimeve të Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara.

### **Neni 19**

#### **Obligimi i subjekteve përgjegjëse për zbatimin e vendimeve të Qeverisë**

1. Subjektet përgjegjëse obligohen që të përcjellin vendimet e Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara dhe listën e sanksioneve të shënjestruara dhe të zbatojnë vendimet e Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara, pa vonesë, brenda kufijve të kompetencave të tyre.
2. Subjektet përgjegjëse i raportojnë institucioneve koordinuese nga neni 18 i këtij ligji pas ndërmarrjes së secilit veprim lidhur me zbatimin e vendimeve të Qeverisë për vendosjen dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.
3. Subjekte përgjegjëse janë: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Policia e Kosovës, noterët, institucionet financiare, institucionet tjera kompetente që mbajnë ose administrojnë regjistra të fondeve dhe pasurive, si dhe të gjitha subjektet e tjera relevante.

**Neni 20****Administrimi i Fondeve dhe Resurseve Ekonomike të Sekuestruara**

1. Fondet dhe resurset ekonomike të cilat sekuestrohen në bazë të vendimit të Qeverisë për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara, të evidentuara e të verifikuara nga subjektet përgjegjëse nën koordinimin e Njesisë për Inteligjencë Financiare, kalojnë nën administrimin e Agjencisë përkatëse për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, fondet që gjenden pranë institucioneve financiare, sekuestrohen dhe administrohen nga institucionet financiare përkatëse.
3. Procedurat dhe rregullat lidhur me administrimin e pasurisë së sekuestruar sipas këtij ligji zbatohen përshtatshëm në përputhje me legjislacionin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar.

**KAPITULLI VII****SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE, MBROJTJA NGA PËRGJEGJËSIA DHE RAPORTIMI NË KUVEND****Neni 21****Sanksionet kundërvajtëse**

1. Kushdo që kryen veprimet si në vijim, konsiderohet se ka kryer kundërvajtje, përveç në rastet kur këto veprime paraqesin vepër penale:
  - 1.1. nuk zbaton ose zbaton me vonesë vendimin e Qeverisë për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara;
  - 1.2. nuk raporton ose raporton me vonesë lidhur me zbatimin e vendimit të Qeverisë për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara;
  - 1.3. nuk zbaton ose zbaton me vonesë vendimin e Ministrit përkatës për Punë të Jashtme lidhur me përjashtimet e zbatimit të vendimit të Qeverisë për vendosjen e sanksioneve të shënjestruara.
2. Gjykata kompetente, për kryesin e kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni, shqipton këto sanksione kundërvajtëse:
  - 2.1. për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik, gjobë në vlerën prej një mijë (1.000) euro deri në dy mijë (2.000) euro dhe ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
  - 2.2. për personin fizik që ushtron biznes individual, gjobë në vlerën prej tremijë (3.000) euro deri në pesë mijë (5.000) euro;
  - 2.3. për personin juridik, gjobë në vlerën prej dymbëdhjetë mijë (12.000) euro deri në njëzet mijë (20.000) euro.
3. Ministria përkatëse për Punë të Jashtme inicion procedurën kundërvajtëse në gjykatën me kompetencë territoriale.
4. Sanksionet kundërvajtëse të përcaktuara në këtë nen shqiptohen në përputhje me ligjin përkatës për kundërvajtjet.

**Neni 22**  
**Mbrojtja nga përgjegjësia**

1. Sekuestrimi i fondeve dhe resurseve ekonomike ose refuzimi për të vënë në dispozicion fonde ose resurse ekonomike, kur këto veprime janë ndërmarrë në mirëbesim dhe në përputhje me këtë ligj, nuk përbën bazë të asnjë forme të përgjegjësisë për personin fizik, juridik ose organin, përkatësisht institucionin që ndërmerr këto veprime, e as për titullarët ose zyrtarët, përveç nëse këto veprime janë ndërmarrë me neglizhencë.

2. Veprimet e personave fizikë, juridikë ose të organeve, përkatësisht institucioneve, nuk përbëjnë bazë të asnjë forme të përgjegjësisë në rast se ata nuk e kanë ditur dhe nuk kanë pasur arsye për të dyshuar se ato veprime do të ishin në kundërshtim me masat e përcaktuara në këtë ligj.

**Neni 23**  
**Raportimi në Kuvend**

Ministria përkatëse e Punëve të Jashtme raporton një (1) herë në vit në Komisionin përkatës për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me vendosjen, heqjen dhe zbatimin e sanksioneve të shënjestruara.

**KAPITULLI VIII**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 24**  
**Aktet nënligjore**

Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Jashtme, miraton akt nënligjor për përcaktimin e procedurës për vendosjen, zbatimin dhe heqjen e sanksioneve të shënjestruara, në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.

**Neni 25**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-155**  
**7 qershor 2023**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-118/2023, datë 22.06.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**